



Duke u bazuar në nenin 87, paragrafin 2, nënparagrafin 2.5 të Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nxjerr:

UDHËZIMIN ADMINISTRATIV NR. 02/2011/KRPP

Neni 1

Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të ofrojë interpretimin e nenit 59 të Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik, i cili nen rregullon ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve.

Neni 2

Shprehjet e përdorura

Shprehjet e përdorura në këtë udhëzues, kanë kuptimin e përkufizimeve të përcaktuara me nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-241 për Prokurimin Publik.

Neni 3

Udhëzimet procedurale për vlerësimin e tenderëve

Nëse autoriteti kontraktues, gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, konstaton se një tender i plotëson të gjitha kërkesat nga aspekti administrativ dhe teknik, të parashtruara në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, mirëpo vëren se një dëshmi – dokument që i përgjigjet kërkesave qoftë nga aspekti administrativ apo teknik nuk përmban informatë të qartë, atëherë mund të kërkojë sqarim me shkrim nga tenderuesi në mënyrë që ta qartësojë informatën e dhënë në atë dokument të ofruar me tender. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkojen ose të pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Neni 5

Ndryshimet materiale

“Ndryshime materiale” nga kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, janë ato të cilat: (i) dallojnë në mënyrë thelbësore nga kushtet dhe specifikimet e dosjes së tenderit, (ii) ndikojnë në fushëveprimin, cilësinë ose ekzekutimin e

kontratës, (iii) kufizojnë të drejtat e autoritetit kontraktues ose obligimet e tenderuesit në kontratë, dhe (iv) deformojnë konkurrencën për tenderuesit, tenderët e të cilëve i plotësojnë kushtet.

Neni 6 **Aspektet e një tenderi**

“Aspekte të një tenderi” duhet të konsiderohen të gjitha dëshmit – dokumentet që i përgjigjen kërkesave formale nga aspekti administrativ, si dhe ato që i përgjigjen kërkesave nga aspekti teknik (kushtet, karakteristikat, specifikimet teknike, përshkrimet etj) të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Neni 7 **Refuzimi i një tenderi**

Tenderi i cili nuk përputhet nga aspekti administrativ dhe teknik me dosjen e tenderit, menjëherë duhet të refuzohet dhe nuk mundet gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve të bëhet i përgjegjshëm duke e korigjuar atë.

Neni 8 **Korigjimi i gabimeve aritmetikore**

Nëse gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, vëren autoriteti kontraktues se një tenderues ka bërë gabime aritmetikore gjatë specifikimit të çmimit të ofruar me tender, autoriteti kontraktues mund të korigjojë gabimet e tilla, me kusht që korigjimi i tillë të kuantifikohet për atë sa mund të konsiderohet i rëndësishëm së ulët. Çdo korigjim që qon deri në ndryshime të mëdha materiale, do të konsiderohet jo valide dhe tenderi i tillë do të refuzohet.


Neni 8 **Përgjegjësia e autoriteteve kontraktuese**

Zyrtari i prokurimit dhe personat tjerë që kanë marrë pjesë, kanë inkurajuar marrjen e vendimit mbi korigjimin e gabimeve aritmetikore, ose në ndonjë mënyrë kanë ndikuar në marrjen e vendimit të tillë, do të jenë përgjegjës nëse një vendim i tillë konsiderohet jo ligjor nga Organi i Shqyrtimit të Prokurimit me rastin e shqyrtimit të ankesës ose nga ndonjë Gjykatë kompetente.

Neni 9 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzim Administrativ, hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Dt. 10.03.2011
Prishtinë,


Safet Hoxha - Kryetar i KRPP